



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Proçes verbal

Sot me datë 26.07.2024 ora 10:00 ishte parashikuar mbledhja e **Kryesisë së Këshillit Bashkiak** për shqyrtimin e rendit të ditës për mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak.

Të pranishëm janë:

Z. Oltion Luli

Znj. Irena Shala

Z. Gjergj Sokoli

Mungon:

Z.Blendi Gjylbegaj

Z. Edmond Ndou

Znj. Violeta Perndrecaj

Znj.Valjeta Bajraktari

Kourumi i domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes nuk ishte prezent, prandaj Z.Luli në cilësinë e Kryetarit dhe këshilltarët e pranishëm vendosën për datën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, e cila do zhvillohet ditën e mërkurë dt:31.07.2024 ora 17:00. Këshilltarët prezent u njohën edhe me pikat e rendit të ditës.

Rendi i ditës do jetë si më poshtë:

1. Pr/ Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Qershor 2024".
2. Pr/Vendim: "Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave nga shpenzime korrente tek projektet e investimeve brenda të njëjtit program për vitin 2024"
3. Pr/Vendim: "Dhënie pëlqimi për pranimin e donacionit nga "World Vision Albania", në cilësinë e donatorit për investimin e projektit "Kënd lojrash".
4. Pr/Vendim: "Për miratimin e transferimit të fondit të mbetur gjendje në llogari jashtë thesari, për projektin "Nxitja e Përfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit" nga llogaria e dedikuar e projektit tek të ardhurat e Bashkisë Shkodër dhe përdorimin e tij në funksion të programit 07220 "Shërbimi i kujdesit parësor shëndetësor".
5. Pr/Vendim: "Për strehimin emergjent të Znj.XH.B dhe fëmijëve të mitur në njësinë e banimit tek banesat sociale me qira pranë qendrës komunitare "Për familjen"Nr.6 (ish konvikti i Shkollës Pyjore).





6. *Pr/Vendim: "Dhënie pëlqimi për pranimin e sponsorizimit nga subjekti "Raiffeisen Invest", sh.a në cilësinë e sponsorizuesit për investimin dhe zbatimin e projektit "Rikualifikimi i hyrjes së disa shkollave të qytetit, Shkodër", sipas projektit të miratuar nga Bashkia Shkodër.*

7. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Të tjera pyetje e diskutime nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

SEKRETARE

Sabina DANAJ

Zbardhi Proces verbalin:

Irma Sulishti

